

Universiteti i Prishtinës**SYLABUS për lëndën: SISTEMI EMËROR DHE SISTEMI FOLJOR I SHQIPES**

Të dhëna bazike të lëndës		
Njësia akademike:	Fakulteti i Edukimit	
Titulli i lëndës:	<i>SISTEMI EMËROR DHE SISTEMI FOLJOR I SHQIPES</i>	
Niveli:	Master	
Statusi lëndës:	Zgjedhore	
Viti i studimeve:		
Numri i orëve në javë:	3	
Vlera në kredi – ECTS:	6	
Kodi dhe shifra e lëndës		
Mësimdhënësit e lëndës:	Emri	Kontakti
	Prof. asc. dr. NaserPajaziti	naser_pajaziti@yahoo.com
		Celulari: 044 149-265

Përshkrimi i lëndës	Gjatë ligjëratave në <i>Sistemi emëror dhe sistemi foljor i shqipes</i> në saje edhe të të nxënit (nga shkollimi paraprak), studentët do kenë mundësi t'i zgjerojnë njohuritë e tyre edhe në fushën e morfologjisë, si për: objektin e studimit të morfologjisë, strukturën morfologjike të fjalës, elementet e fjalëformimit: morfemat fjalëformuese dhe trajtëformuese; pjesët e ndryshueshme të ligjëratës: emrin, (nyjat), mbiemrin, numërorin, përemrin, foljen; pjesët e pandryshueshme: ndajfoljet, parafjalët, lidhëzat, pjesëzat, pasthirrat etj
Qëllimet e lëndës:	<ul style="list-style-type: none"> - Qëllimi i kursit <i>Sistemi emëror dhe sistemi foljor i shqipes</i> është që studentët: - T'i thellojnë dhe zgjerojnë njohuritë e tyre në fushën e gjuhësisë në përgjithësi e të strukturës së fjalës (morfologjisë) në veçanti, si disiplinë shumë e rëndësishme për mësimin e gjuhës shqipe standarde; - Të njihen me strukturën e fjalës dhe mënyrat e fjalëformimit me qëllim të formimit të fjalëve të reja si formë e mirë e pasurimit dhe pastrimit të fjalësit të tyre; - Të fitojnë aftësi për të dalluar trajtat dhe format normative nga ato jonormative në ligjërimin e folur dhe në atë të shkruar, në mënyrë që t'i zbatojnë këto aftësi në të ardhmen te nxënësit e ciklit të ulët të shkollës fillore.
Rezultatet e pritura të nxënies:	<ul style="list-style-type: none"> - Studentët do të jenë në gjendje:

	<ul style="list-style-type: none"> - T'i dallojnë trajtat fjalëformuese nga ato trajtëformuese; pjesët e ndryshueshme të ligjëratës nga ato të pandryshueshme; sinonimet nga homonimet e antonimet dhe anasjelltas etj. - T'i përdorin këto pjesë të ligjëratës për një gjuhë sa më funksionale, të kuptueshme dhe shprehëse, si në formën e folur ashtu edhe në atë të shkruar; - T'i përkufizojnë, paraqesin, krahasojnë dhe zbatojnë ato pjesë sipas rregullave të shqipes standarde.
--	---

Kontributi në ngarkesën e studentit (gjë që duhet të korrespondojë me rezultatet e të nxënit të studentit)

Aktiviteti	Orë	Ditë/javë	Gjithësej
Ligjërata	3	1 – 15	45
Ushtrime teorike	2	1 – 15	30
Kontakte me mësimdhënësin/konsultime	2	1 – 15	30
Kolokuiume, seminare	4	2 – 2	8
Detyra të shtëpisë	3	1 – 8	15
Koha e studimit vetanak të studentit (në bibliotekë ose në shtëpi)	2	2 – 10	20
Përgatitja përfundimtare për provim	3	1 – 3	9
Koha e kaluar në vlerësim (teste, kuiz, provim final)	4	3 – 5	20
Projektet, prezantimet etj.	2	1 - 2	4
Totali			181

Metodologjia e mësimdhënies:	Si forma mësimi të këtij kursi të rregullt do të jenë: ligjëratat, bisedat, diskutimet, puna individuale, puna në grupe, seminarët, projektet ideore etj., duke aplikuar me këtë rast strategjitë dhe teknikat e reja mësimore, si: <i>insertin; parashikimin me terma paraprakë; pesëvargëshin; kubimin; kllasterin, analiza e tipareve semantike, tabelën koncepteve, diagrami i Venit, ditari dy/tripjesësh, harta e të menduarit...</i> , si dhe teknika e modele të tjera mësimi, për një mësim më të avancuar e efektiv të gjuhës dhe të standardit të saj.
Metodat e vlerësimit:	<i>Vlerësimi do të bëhet duke u mbështetur në vlerësimet me shkrim (teste), seminare, detyra të shtëpisë, angazhime në klasë dhe në testin përfundimtar.</i>
Literatura	

Literatura themelore:	<p>-Grup autorësh (2002). Gramatika e gjuhës shqip I. Tiranë: Akademia Shkencave e Shqipërisë.</p> <p>-Çeliku, M. & Karapinjalli, M. & Stringa, R. (1998). Gramatika praktike e gjuhës shqipe. Tiranë: Toena.</p> <p>-Demiraj, Sh. (1988). Gramatika historike e gjuhës shqipe. Tiranë: Akademia e Shkencave e Shqipërisë.</p> <p>-Çeliku, M. (1988). Probleme të morfologjisë së gjuhës së sotme shqipe. Tiranë: Libri universitar.</p> <p>Beci, B. (2005). Gramatika e gjuhës shqipe. Shkup: Logos A.</p>
Literatura shtesë:	Jashari, A. & Kryeziu, B. (2010). Gjuhë amtare. Prishtinë: Universiteti i Prishtinës.

Plani i detajizuar i mësimi:

Java	Ligjërata që do të zhvillohet
Java e parë:	Sistemi emëror i shqipes
Java e dytë:	Morfema dhe fjala
Java e tretë:	Analiza morfematike dhe analiza fjalëformuese
Java e katërt:	Emri
Java e pestë:	Kategoritë leksiko-gramatikore të emrit
Java e gjashtë:	Mbiemri dhe Numërori
Java e shtatë:	Përemri
Java e tetë:	Sistemi i nyjave
Java e nëntë:	Test i parë intermediar
Java e dhjetë:	Sistemi foljor i shqipes
Java e njëmbëdhjetë:	Kategoritë gramatikore të foljes

<i>Java e dymbëdhjetë:</i>	Zgjedhimi i foljeve
<i>Java e trembëdhjetë</i>	Ndajfolja dhe parafjala
<i>Java e katërbëdhjetë</i>	Lidhëza, pjesëza dhe pasthirma
<i>Java e pesëmbëdhjetë</i>	Testi i dytë intermediar